

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7188
E shtunë, 18 maj 2024
Çmimi 0.50 €

Escobari: Është dashur të insistojmë më shumë në zbatimin e Asociacionit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMITETI I MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS (KIE) NUK E PËRFSHIN NË AGJENDË ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KIE | FAQE 4-5

KOSOVA HUMBI RASTIN HISTORIK PËR T'U ANËTARËSUAR NË KIE



Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (KIE) nuk e ka përfshirë në agjendë çështjen e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Mospërfshirja në agjendë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk e ka plotësuar kushtin për dërgimin

e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese. Kryesuesja e deritanishme e Komitetit të Ministrave të KIE-së, Dominique Hasler, ka bërë me dije se ky komitet është duke e shqyrtuar opsionin se si ta procedojë pranimin e

Kosovës në këtë organizatë. Derisa opozita e ka fajësuar pushtetin për këtë dështim, presidentja Osmani ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në KIE është vetëm çështje kohe, ndërsa kryediplomatja Gërvalla ka thënë se ky proces nuk mund të ndalet

NAGAVCI KËRKON BASHKËPUNIMIN E KOMUNAVE PËR NDËRTIMIN E ÇERDHEVE TË REJA

F. 3



SHOQËRIA CIVILE: KOMISIONET PËR POZITA TË LARTA DREJTUESE PO BËHEN NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KOSOVA DHE BRITANIA, MEMORANDUM NË FUSHËN E MBROJTJES F. 3

LANSOHET PLATFORMA 'E-KOMUNAT', KURTI: QYTETARI BËHET PJESË AKTIVE E VENDIMMARRJES F. 6

OSMANI: QEVERI ME SHQIPTARË JOLEGJITIMË, KËTË E BËNTE MILLOSHEVIQI NË KOSOVË F. 3

KËRKOHEM QË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA T'U SIGUROHEM TRANSPORTI F. 7

EKONOMI



NAFTËTARËT DREJT FALIMENTIMIT, I BËJNË THIRRJE QEVERISË TË MARRË MASA PËR ÇMIMET F. 8

'SINDIKATAVE PO U CENOHEM PËRFAQËSIMI NË BORDIN E TRUSTIT'

F. 8

SPORT



MEZANI: DERBI NDAJ DRITËS, JETIK PËR GJILANIN F. 12

NATO: Rusët nuk kanë numra dhe aftësi për përparim strategjik në Ukrainë

BRUKSEL, 17 MAJ - Edhe pse Moskë ka deklaruar se do ta vazhdojë ofensivën në Ukrainë, NATO dyshon se Rusia ka burime për të bërë një përparim të madh. Oficeri i lartë ushtarak i NATO-s ka thënë se forcat e armatosura të Rusisë janë të paafta për ndonjë përparim të madh. "Rusët nuk kanë numrat e nevojshëm për të bërë një përparim strategjik. Për më tepër, ata nuk kanë aftësinë për ta bërë këtë; për të vepruar në shkallën e nevojshme për të shfrytëzuar çdo përparim në avantazhin strategjik", ka thënë komandanti suprem i aleatëve të

NATO-s në Evropë, Christopher Cavoli.

Komentet e tij vijnë derisa forcat ukrainase përfshihen në beteja të ashpra me trupat ruse për kontrollin e Vovchansk, një qytet kyç në rajonin verilindor të Ukrainës, Kharkiv. Raportohet se Vovchank, i vendosur vetëm 5 kilometra nga kufiri rus, ka qenë pikë e nxehtë ditët e fundit.

I pyetur nëse Rusia do ta nisë më herët ofensivën e saj të parashikuar, komandanti i lartë i NATO-s, Cavoli, ka thënë: "Nuk mund të jemi kurrë të sigurt". Ai ka theksuar se "ajo që ne nuk shohim është se një numër i



madh rezervash po krijohen diku, të nevojshme për një

ofensivë të tillë". Rusia ka filluar një operacion në

Kharkiv javën e kaluar, duke shënuar inkursionin e saj më të rëndësishëm kufitar që nga fillimi i pushtimit në shkallë të plotë në vitin 2022. Lëvizja ka ngritur presion mbi forcat e armatosura të Ukrainës, të cilat janë duke pritur furnizime ushtarake nga Perëndimi.

Edhe pse ukrainasit kanë treguar rezistencë, presidenti Volodymyr Zelensky e ka pranuar se situata "është e vështirë".

Instituti për Studimin e Luftës me bazë në ShBA ka llogaritur se ushtria e Moskës ka përparuar jo më shumë se 8 kilometra nga kufiri i përbashkët në Kharkiv.

ShBA-ja ka nisur dërgesat me ndihma përmes portit në Gazë

WASHINGTON, 17 MAJ - Kamionë me ndihmat e nevojshme humanitare për Rripin e Gazës kanë kaluar për herë të parë më 17 maj përmes portit të ri të ndërtuar nga Shtetet e Bashkuara për në enklavën e rrethuar, pasi Izraeli ka kufizuar kalimet nëpër kufijtë tokësorë.

Zyrtarët ushtarakë amerikanë thanë se presin që deri në 150 kamionë me ndihma të hyjnë në Rripin e Gazës në kohën kur Izraeli po vazhdon luftën në jug, në qytetin e Rafahut, kundër Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga



ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Por, ShBA-ja dhe grupet e ndihmës kanë paralajmëruar se projekti i portit nuk mund të shihet si zëvendësim për dërgesat tokësore,

të cilat do të mund të sillnin të gjithë ushqimin, ujin dhe karburantin e nevojshëm në Gazë. Para nisjes së luftës, mbi 500 kamionë me ndihma kanë hyrë mesatarisht në ditë në Gazë.

Austini ka thënë se s'ka tregues që Hamasi po planifikon sulm ndaj forcave amerikane.

Suksesi i operacionit për dërgesën e ndihmave vihet në rrezik nga sulmet, pengesat logjistike dhe për shkak të rritjes së mungesës së furnizimeve me karburante për kamionët që bartin ndihma, pasi Izraeli ka bllokuar dërgesat e

karburanteve për në Rripin e Gazës pas nisjes së luftës më 7 tetor.

Lufta ka nisur pasi Hamasi ka sulmuar jugun e Izraelit më 7 tetor, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Më shumë se 3 000 palestinezë janë vrarë në luftë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë. Ndërsa zyrtarët lokalë shëndetësorë kanë thënë se qindra të tjerë janë vrarë në Bregun e pushtuar Perëndimor. Komanda Qendrore e Ushtrisë së ShBA-së ka pranuar se ndihma ka nisur të hyjë në Gazë përmes

portit. Në një deklaratë të premtën, Komanda ka thënë se dërgesa e parë me ndihmë hyri në Gazë në orën 09:00 sipas kohës lokale.

ShBA-ja ka thënë se asnjë ushtar amerikan nuk ka marrë pjesë në këtë operacion.

Trupat amerikane kanë përfunduar ndërtimin e portit të enjten. Disa orë më vonë, Pentagoni, ka thënë se ndihma humanitare do të nisë të dërgohet përmes portit, duke shtuar se këto përpjekje po koordinohen me Kombet e Bashkuara.

Zgjedhjet evropiane, Rutte me 'karton të kuq' për shkak të bashkëpunimit me ekstremimin e djathtë

AMSTERDAM, 17 MAJ - Partia Popullore për Liri dhe Demokraci e kryeministrit në largim të Holandës, Mark Rutte, rrezikon të përjashtohet nga grupi politik evropian i liberalëve "Renew Europe" për shkak të marrëveshjes për të formuar një qeveri me partinë e ekstremit të djathtë PVV të Geert Wilders. Kartoni e "kuq" për liberalët

holandezë tashmë e ka treguar kandidatja kryesore e listës së liberalëve në zgjedhjet evropiane, Valerie Aeyh, e cila ka kërkuar një mbledhje të partive që përbëjnë Renew më 10 qershor, menjëherë pas zgjedhjeve.

"PVV (Partia për Liri) është saktësisht e kundërta e asaj që ne mbështesim për vlerat e shtetit ligjor, klimës, ekonomisë dhe



rrugës drejt Evropës. Marrëveshja me një palë të tillë do të thotë që ne t'i lëmë mënjane vlerat që mbajmë. Kompromisi me ekstremimin e djathtë nuk është i pranueshëm", ka thënë Aeyh.

Të njëjtën gjë e ka thënë edhe partia tjetër liberale e Holandës, D66. Socialistët, të Gjellbrit, Liberalët dhe të Majtët kanë

nënshkruar tashmë një deklaratë të përbashkët më 8 maj, në të cilin ata refuzojnë çdo bashkëpunim me partitë e ekstremit të djathtë.

Partia e Mark Rutte ka fituar 5 deputetë në zgjedhjet e nëntorit të kaluar. Nëse VVD përjashtohet nga eurogrupi i Renew, mund të bashkohet me Partinë Popullore Evropiane (EPP).

Thellohet bilanci i luftës në Gaza, shkon në mbi 35 mijë numri i palestinezëve të vrarë

GAZA, 17 MAJ - Ka shkuar në 35 mijë e 303 numri i palestinezëve të vrarë nga sulmet e vazhdueshme izraelite në Rripin e Gazës që nga 7 tetori i vitit të kaluar. Kështu ka bërë me dije Ministria e Shëndetësisë e Gazës. Në një deklaratë të ministrisë është thënë se 79 mijë e 261 persona të tjerë janë plagosur. "Sulmet

izraelite vranë 31 persona dhe plagosën 56 të tjerë në 24 orët e fundit. Shumë njerëz janë ende të bllokuar nën rrënoja dhe në rrugë", është thënë në deklaratën e Ministrisë së Shëndetësisë.

Izraeli ka vazhduar ofensivën ushtarake në Rripin e Gazës pavarësisht një rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së

që kërkonte një armëpushim të menjëhershëm në enklavë.

Izraeli është duke u akuzuar për "gjenocid" në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila ka urdhëruar Tel Avivin të sigurojë që forcat e tij të mos kryejnë akte gjenocidi dhe të marrin masa për ta garantuar ofrimin e ndihmës humanitare për civilët në Gaza.



Osmani: Qeveri me shqiptarë jolegjitimë, këtë e bënte Millosheviqi në Kosovë

SHKUP, 17 MAJ - Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka vlerësuar se Fronti Evropian paraqet vullnetin e shumicës shqiptare dhe jo koalicioni VLEN që ka fituar më pak vota për t'i përfaqësuar shqiptarët në qeverinë e re. Ai ka deklaruar se qeveri me shqiptarë jolegjitimë dhe qeveri pa shqiptarët është koncept i njëjtë. "Qeveri me shqiptarë jolegjitimë dhe qeveri pa shqiptarët është një

koncept i njëjtë. Unë ju them Millosheviqi e ka bërë këtë në Kosovë. Rrahman Morinën e vendosi kryetar të Kosovës, ndërsa shqiptarët thoshin: kush është ky?", ka thënë Osmani.

Nënkryetari i BDI-së ka theksuar se gjatë formimit të qeverisë nuk mund të funksionojë modeli i "shqiptarëve të preferuar". "Ne kishim një garë të rëndë me VLEN-in dhe kemi fituar. Pse shumica e shqiptarëve

vendosën në mes të Frontit Evropian dhe VLEN-it, nëse vota e tyre nuk vlen? Ky debat është serioz. Marrëveshja e Ohrit ka sjellë mekanizma për mbrojtje të bashkësive joshumicë. Dhe kjo nuk është e BDI-së. Kjo do t'i hidhërojë të gjithë shqiptarët për shkak se ata do të vendosin të ndjenjë se vota e tyre është e pavlefshme dhe do të hapë shumë tema dhe tema të tilla nuk janë të nevojshme", ka thënë Bujar Osmani për "Kanal5".



Escobari: Është dashur të insistojmë më shumë në zbatimin e Asociacionit

UASHINGTON, 17 MAJ - I dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se është dashur të insistohet më shumë në zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe sesa në afrimin e Kosovës dhe Serbisë.

"Është dashur të insistojmë më shumë në zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në vend se ta lehtësonim afrimin e të dyja palëve sepse në disa raste kemi vërejtur se ka pasur vullnet nga të dyja palët", ka thënë Escobari në një intervistë për Qendrën e Evropës në Këshillin e Atlantikut. I pyetur nëse prioriteti i Asociacionit ka qenë strategjia

më efektive, Escobari ka thënë se çështja e zbatimit të Asociacionit është më e vështira.

"Prandaj, ishte e rëndësishme që Kosova ta sinjalizonte vullnetin e saj për ta adresuar çështjen e minoriteteve, të minoritetit serb brenda kufijve të saj. Kjo është e rëndësishme", tha ai.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe 2015 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Po ashtu, vitin e kaluar palët kanë arritur Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve, që parasheh sigurimin e një niveli të përshtatshëm të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë. Brukseli ka thënë se vetëmenaxhimi nënkupton



Asociacion. ShBA-ja dhe BE-ja Kosova ta themelojë vazhdimisht kanë insistuar që Asociacionin.

Escobari ka thënë se zbatimi i Asociacionit është kyç në rrugën e Kosovës drejt BE-së dhe për sigurimin e njohjeve të reja. "Nga perspektiva amerikane, për shkak se rruga evropiane ka përfshirë pjesë të këtij Asociacioni në çdo hap, ne besojmë se duke pranuar propozimin evropian, përmes procesit evropian që është dialogu, dhe marrëveshja që është e garantuar nga BE-ja, do t'i jepte palës amerikane një mundësi për të lobuar te shtetet evropiane, për të thënë se Kosova ka bërë gjithçka që ka kërkuar Evropa, prandaj ka arsye për njohje të reja. Pa këtë, le të themi, ne nuk kemi pasur material për ta bërë një gjë të tillë", ka thënë ai.

Molliqaj: S'po na kushtëzojnë me marrëveshjen e Thaçit dhe Mustafës, por me atë të Kurtit në Ohër



PRISHTINË, 17 MAJ - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka thënë për kushtëzimin për anëtarësim në Kosovës në Këshillin e Evropës ndërlidhet me pranimin e marrëveshjes nga kryeministri Albin Kurti në Ohër dhe jo me ato paraprake.

Ndonëse ndien keqardhje për mosanëtarësimin e Kosovës në KiE, Molliqaj ka thënë se kjo, fatmirësisht, nuk është bërë si këmbim për themelimin e Asociacionit. Molliqaj për "Ekonomia Online"

ka thënë se janë kundër që të themelohet Asociacioni, siç e ka quajtur, "autonomi serbe", si kusht për anëtarësim në KiE. "Ne jemi kundër që të themelohet autonomia serbe në Kosovë për anëtarësim në Këshillin e Evropës, por jemi tërësisht të bindur që tek kjo pikë kemi ardhur si rezultat i veprimeve të Kurtit për më shumë se tri vjet në dialog. Nuk po na kushtëzojnë as me marrëveshjen e Thaçit e as me marrëveshjen e Mustafës, por po na kushtëzojnë me marrëveshjen e Ohrit që Kurti e ka pranuar që në rrugën për

anëtarësim në organizatat ndërkombëtare duhet të ketë implementim të përgjithshëm të marrëveshjes dhe nuk po na kushtëzojnë me ndonjë draft ose me ndonjë marrëveshje tjetër, por po na kushtëzojnë me draftin e BE-së që Kurti i ka thënë 'po'. Në njërin anë shumë keq që nuk jemi anëtarësuar, në tjetrën shumë mirë që nuk kemi bërë hapa drejt themelimit (të Asociacionit), ndonëse është e qartë që do t'i bëjmë ato, vetëm me një dëm edhe më të madh më vonë", ka thënë Molliqaj.

Kosova dhe Britania, memorandum në fushën e mbrojtjes

LONDËR, 17 MAJ - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije se me ministrin e Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe, Leo Docherty, kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit ndërmjet dy ministrive. Ai ka thënë se ky memorandum do ta formësojë edhe më tutje bashkëpunimin e shkëlqyeshëm bilateral në

fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve. "Kjo marrëveshje, që do ta formësojë edhe më tej bashkëpunimin e shkëlqyeshëm bilateral në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve tona, përfshin koordinimin për mbështetjen e integritetit të Republikës së Kosovës në NATO, realizimin e ushtrimeve dhe trajnime të përbashkëta, mbështetje dhe

trajnime për operacione ndërkombëtare dhe misione ushtarake, si dhe shkëmbim përvojash në fusha të tjera. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës është mirënjohëse ndaj Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e pakursyer dhe të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit tonë", ka njoftuar Maqedonci.





KOMITETI I MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS (KIE) NUK E PËRFSHIN NË AGJENDË ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KIE

Kosova humbi rastin historik për t'u anëtarësuar në KiE

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE) nuk e ka përfshirë në agjendë çështjen e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Mospërfshirja në agjendë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk e ka plotësuar kushtin për dërgimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese. Kryesuesja e deritanishme e Komitetit të Ministrave të KiE-së, Dominique Hasler, ka bërë me dije se ky komitet është duke e shqyrtuar opsionin se si ta procedojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë. Derisa opozita e ka fajësuar pushtetin për këtë dështim, presidentja Osmani ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në KiE është vetëm çështje kohe, ndërsa kryediplomatja Gërvalla ka thënë se ky proces nuk mund të ndalet

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 MAJ - Republika e Kosovës ka mbetur jashtë agjendës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE) për anëtarësim në këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare. Mospërfshirja në agjendë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk e ka plotësuar kushtin për dërgimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese. Në plotësimin e këtij kushti kanë insistuar Franca, Gjermania dhe Italia, ndonëse një ditë para mbledhjes së mbledhjes së Komitetit të Ministrave të KiE-së, ministria e Punëve të Jashtme

dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, nëpërmjet një letre drejtuar Asamblesë Parlamentare të KiE-së, ishte zotuar se Qeveria e Kosovës do ta hartojë një draft-statut të Asociacionit, duke e anashkaluar atë të Bashkimit Evropian (BE). Megjithatë, vendet anëtare kanë shprehur gatishmëri që Kosova të mund të bëhet anëtare në një fazë të mëvonshme, nëse e plotëson kushtin e kërkuar nga Franca, Gjermania dhe Italia. Pavarësisht prej kësaj, kryesuesja e deritanishme e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE), Dominique Hasler, ka thënë se ky komitet është duke e shqyrtuar një opsion se si ta

procedojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë.

Hasler, që është ministre e Jashtme e Lihtenshtajnit, shteti i cili ka pasur udhëheqjen e presidencës së KiE-së, pas mbledhjes së Komitetit të Ministrave, ka thënë të premtën se Kosova është përmendur në mbledhje nga shtetet anëtare. "Pranimi i Kosovës u përmend disa herë sot (e premtë) në kuadër të deklaratave kombëtare të ministrave. Ne kemi pranuar letër nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me rekomandimin për pranimin e Kosovës dhe ne bëmë gjithçka brenda presidencës sonë për ta avancuar procesin, së bashku me shtetet anëtare. Dhe Komiteti i Ministrave veçse ka nisur diskutimet për çështjen dhe aktualisht po shqyrtos se si të procedojë", ka thënë ajo. Ndërsa kryeministria e Lituanisë, Ingrida Simonyte, ka thënë se kur bëhet fjalë për pranimin e Kosovës, çështja nuk ka të bëjë me atë nëse duhet të pranohet, por kur.

Kosova veçse ka kaluar dy faza në procesin e pranimin në këtë organizatë, dhe Komiteti i Ministrave është ai që vendos nëse një shtet do të pranohet ose jo në Këshillin e Evropës. Pas kalimit të rekomandimit për pranimin e Kosovës në Asamblesë Parlamentare të KiE-së, disa shtete vendosën kusht që Kosova ta themelojë

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe nëse dëshiron të bëhet anëtare e organizatës me seli në Strasburg.

Më 16 maj, përmes një letre dërguar Këshillit të Evropës, Kosova tha se zotohet se do të hartojë një draft-statut për Asociacionin dhe të njëjtin do ta dërgojë për interpretim në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të majit. Me këtë zotim, Kosova ka thënë se përmbushi kushtin e vënë nga disa anëtarë të Këshillit të Evropës dhe Prishtina kërkoi që të bëhet anëtare e kësaj organizate evropiane për të drejtat e njeriut. Por, Gjermania, një prej shteteve që ka vendosur kushtin për Kosovën në KiE, ka thënë se ajo konsideron si "hap konkret" vetëm kur Kosova ta dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese draft-statutin për Asociacionin.

Deri më tani janë prezantuar disa draft-statute për Asociacionin, përfshirë një nga BE-ja në tetorin e vitit të kaluar. Por, në letrën dërguar KiE-së, Kosova ka thënë se mëton ta hartojë draftin e saj, duke u frymëzuar nga drafti i prezantuar nga organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung.

Në fund të janarit të vitit 2023, FES-i ka publikuar një draft-statut për themelimin e Asociacionit në përputhje me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Kosovës, ashtu siç insiston edhe qeveria e kryeministrit Albin Kurti.

Osmani: Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës, çështje kohe

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premtën se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE) është "çështje kohe", pasi kërkesa e saj për t'iu bashkuar kësaj organizate të rëndësishme për të drejtat e njeriut nuk u mor parasysh nga Komiteti i Ministrave të KiE-së.

"Republika e Kosovës do të jetë anëtarja e 47-të e Këshillit të Evropës. Është vetëm çështje kohe. Në këtë rrugë, ne nuk bëjmë kompromis me vlerat të cilat formojnë themelet e vendit tonë", ka shkruar Osmani në platformën "X".

Osmani i ka bërë këto komente pak orë pasi Komiteti i Ministrave të KiE-së nuk e hodhi në votim kërkesën e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë gjatë një takimi të premtën në mëngjes.

Osmani ka thënë se Kosova është "mirënjohëse ndaj të gjitha vendeve që na kanë mbështetur deri tani. Së bashku ne do të punojmë për ta bërë realitet këtë triumf të të drejtave të njeriut pa humbur kohë". "Kur të mbërrijmë atje, ne do të vazhdojmë të ngremë zërin për shtylla të cilat e definojnë KiE-në: të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ne nuk do të shërbejmë si dora e shtrirë e Rusisë, e as si



Kryediplomatja gjermane: Kosova të bëjë gjithçka për ta siguruar shumicën në KiE

Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Analena Baerbock, sërish ka bërë thirrje që Kosova të bëjë gjithçka që të arrihet shumica e kërkuar për anëtarësimin në Këshillin e

Evropës. Këtë deklaratë ajo e ka bërë përpara mbledhjes së Komitetit të Ministrave ku Kosova nuk ka qenë në rend të ditës. "Të gjithë të përfshirët dhe të gjithë përgjegjësit në

Kosovë duhet të bëjnë gjithçka për ta siguruar shumicën e kërkuar në favor të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës që të arrihet së shpejti", ka thënë ajo.

shembull i sjelljes autokratike", ka shkruar presidentja Osmani.

Gërvalla fajëson ndërkombëtarët për dështimin në KiE: Nuk mund të ndalet anëtarësimi i Kosovës

Pas zhvillimeve në Strasburg ka reaguar edhe ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), Donika Gërvalla-Schwarz. Ajo ka thënë se ministrat e punëve të jashtme të vendeve anëtare në Këshillin të Evropës nuk e kanë futur në

agjendën e sotme dhe nuk kanë marrë vendim për thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme për anëtarësimin pa vonesë të Republikës së Kosovës.

Gërvalla ka thënë se në vend të opinionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe një propozimi të arsyeshëm e serioz nga Qeveria e Kosovës, disa vende anëtare kanë zgjedhur t'u dalin në krah padrejtësive dhe t'i japin mbështetje fushatës lobuese të Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës. "Megjithëse sot ishte dita kur do të duhej të votohej anëtarësimi ynë në këtë organizatë dhe në këtë formë të

dërgohej një mesazh i fuqishëm për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në 75-vjetorin e themelimit të Këshillit të Evropës dhe në vigjilje të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës, ministrat e punëve të jashtme të vendeve anëtare nuk e futën në agjendën e sotme dhe nuk morën vendim për thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme për anëtarësimin pa vonesë të Republikës së Kosovës", ka shkruar Gërvalla në "Facebook". Sipas saj, ky qëndrim është në shpërputhje me thirrjen e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila në opinionin e saj ka thënë se Kosova duhet të anëtarësohet pa parakushte shtesë.

"Duke qenë se vendit i ishte vendosur një parakusht i vonshëm, joformal e arbitrar, Qeveria e Republikës së Kosovës bëri një propozim dje (përmes një oferte të shënuar në një komunikim përmes letrës drejtuar KiE-së) të arsyeshëm për tejkalimin e bllokadës që kishte krijuar ky parakusht i fundit. Edhe pse oferta jonë, e konsultuar me partnerë të shteteve anëtare, në këmbim të një vendimi pozitiv sot në Komitet të Ministrave ofroi një platformë të gjerë të punës së përbashkët, ajo ofertë nuk u mor parasysh. Rrjedhimisht ajo letër me ofertë e humbi vetvetiu aktualitetin dhe relevancën pas mbledhjes së sotshme të Komitetit të Ministrave", ka shkruar Gërvalla.

Musliu-Shoshi fajëson Kurtin dhe Gërvallën për mosanëtarësimin e Kosovës në KiE

Në lidhje me zhvillimet në Strasburg ka reaguar edhe deputetja e PDK-së, Ariana Shoshi-Musliu. Ajo e ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti dhe

Krasniqi pas dështimit të Qeverisë së Kosovës në KiE: Zgjedhjet na nxjerrin nga izolimi

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës pas dështimit në Këshillin e Evropës (KiE). Ai ka vlerësuar se Kosova ka humbur mbështetjen nga partnerët ndërkombëtarë.

Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se kjo qeveria ka dështuar ta finalizojë një punë thujse të kryer. Në këtë kontekst, Krasniqi ka vlerësuar se zgjedhjet janë vetëm zgjedhjet e reja. "Sot është një ditë e hidhur për Kosovën dhe për qytetarët tanë. Sot do të duhej ta festonim pranimin në Këshillin e Evropës. Në vend se të konkretizonim një sukses që do ta forconte demokracinë, sundimin e ligjit dhe shtetësinë tonë e për çfarë është punuar gjatë, sot jemi dëshmitarë të humbjes së mbështetjes nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Kjo qeveri, ky

pushtet, pa përjashtuar asnjë nga përgjegjësit e institucioneve shtetërore, dështoi ta finalizojë një punë thujse të kryer. Mbështetjen e ktheu në injorim. Besimin në zhgënjim. E të ardhmen e sigurt të qytetarëve tanë - e shndërroi në faturë të lartë politike që duhet ta paguajnë po ata", ka shkruar Krasniqi.

Ai ka bërë me dije se sot ky pushtet zyrtarisht ka humbur legjitimitetin. "Prandaj, shkuarja në zgjedhje të parakohshme, krijimi i një qeverie të re, kredibile, kompetente dhe të përgjegjshme, që e heq Kosovën nga izolimi dhe e orienton nga integrimi i sigurt euroatlantik, është e domosdoshme. Sot edhe zyrtarisht ky pushtet e ka humbur legjitimitetin. Shteti ka nevojë për qytetarët dhe ata duhet ta thonë fjalën e tyre!", ka shkruar Krasniqi.



kryediplomatën Donika Gërvalla për mosanëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. "Fatkeqësia e Kosovës është që falë udhëheqjes së Albin Kurtit sot feston Serbia me mosanëtarësimin e Kosovës në KiE! Injorantë e keqdashës për

Kosovën deri në palcë! Nuk duan, nuk dinë, nuk munden! P.S. Tregoni Donikës që opinionin i Asamblesë së Këshillit të Evropës është vetëm rekomandim për Komitetin e Ministrave", ka shkruar Musliu-Shoshi në "Facebook".

Dështimi për anëtarësim në KiE, Grenelli: Kurti po e pengon Kosovën, miqtë e mi meritojnë më mirë

Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka reaguar pasi Kosova ka dështuar të anëtarësohet të premtën në Këshill të Evropës. Grenelli ka thënë se kryeministri Albin Kurti është duke e penguar Kosovën dhe se, sipas tij,

qytetarët meritojnë më mirë. "Kurti po e pengon Kosovën. Është e trishtueshme. Miqtë e mi në Kosovë meritojnë më mirë. Aq shumë përparim mund të bëhet për normalizimin e marrëdhënieve nëse marrëveshjet thjesht do të zbatoheshin", ka shkruar Grenelli në platformën "X".



Kryediplomati shqiptar: Mosanëtarësimi në KiE, mundësi e humbur historike për Kosovën

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, ka thënë se dështimi për të vendosur për anëtarësimin e Kosovës në ministerialin e Këshillit të Evropës është një mundësi e humbur historike për Kosovën që të ketë një vend të merituar në tryezë dhe një zë më të fortë në formimin e një Evrope të bashkuar dhe demokratike. Ai ka thënë se është e nevojshme që Qeveria e Kosovës të veprojë me shpejtësi për t'i përbushur zotimet që

ka marrë dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive me partnerët dhe përkrahësit e saj të vendosur ndërkombëtarë. "Kjo duhet të pasohet me përpjekje kolektive që në të ardhmen e afërt të mbahet një tjetër Komitet i Ministrave të KiE. Të gjithë duhet të veprojmë me shpejtësi për të përbushur çka i kemi borxh popullit të Kosovës", ka shkruar Hasani në "Facebook", i cili ka marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të KiE-së.

Nagavci kërkon bashkëpunimin e komunave për ndërtimin e çerdheve të reja

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MAJ - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHIT), Arbërie Nagavci, ka deklaruar se kanë siguruar buxhetin për ndërtimin e institucioneve parashkollore si dhe kanë bërë të gjitha analizat, buxhetet e projektet e gatshme për komunat, të cilat duhet t'i gjejnë lokacionet që i plotësojnë nevojat. Nagavci në një konferencë për medie ka njoftuar se u ka bërë thirrje kryetarëve nga të gjitha komunat e Kosovës që t'i përgjigjen ftesës për bashkëpunim në ndërtimin e çerdheve të reja. "Sot kam nisur një letër tek të gjithë kryetarët e komunave për të kërkuar angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre në ndërtimin e çerdheve. Përmes kësaj letre kam kërkuar që të angazhohen personalisht që t'i pranojnë kërkesat e kompletuara, në mënyrë që të vazhdojmë procedurat e tjera për ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve për të



mundësuar kështu edukimin në fëmijërinë e hershme", ka thënë Nagavci në një konferencë për medie.

Ajo ka thënë se Ministria e Arsimit vitin e kaluar ka bërë një analizë në nivel vendi, ku për planifikimet është njoftuar në vazhdimësi në

takimet e rregullta që ka pasur me zyrtarë komunalë. "Ne gjatë vitit të kaluar kemi hartuar katër projekte modulare të cilat i kemi vënë në

dispozicion të komunave për t'i përshtatur me lokacione. Projektet modulare i kemi finalizuar si projekte, me siguri, kohë të shkurtër dhe ndarjen e buxhetit të nevojshëm. Kemi siguruar buxhetin për ndërtimin e institucioneve parashkollore. I kemi të gjitha analizat, i kemi buxhetet dhe projektet janë të gatshme dhe komunat t'i gjejnë lokacionet që i plotësojnë nevojat", ka thënë Nagavci.

Ndërsa zëvendësministri i Arsimit, Taulant Kelmendi, ka treguar edhe për shumat që janë ndarë për ndërtimin e çerdheve nëpër komuna. "Në këtë kontekst, kemi buxhet të garantuar, projekte të gatshme. Vetëm kërkojmë që komunat t'i përgjigjen gatishmërisë sonë. Nga janari kemi pesë kërkesa nga komunat për ndërtimin e çerdheve. 799 mijë euro për ndërtimin e çerdhes në Prizren, 742 mijë euro për në Suharekë, 81 mijë euro në Gjilan. Në Babush të Ferizajt 98 mijë dhe 85 mijë euro në Junik", ka thënë Kelmendi.

Lansohet platforma 'E-Komunat', Kurti: Qytetari bëhet pjesë aktive e vendimmarrjes



PRISHTINË, 17 MAJ - Qeveria e Kosovës ka lansuar të premten platformën "E-Komunat" në kuadër të platformës "E-Kosova". Me këtë rast, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shërbimet e reja në kuadër të platformës "E-Komunat" do ta rrisin interaksionin në mes të organeve komunale dhe qytetarëve. "Këto shërbime rrisin

interaksionin në mes të organeve komunale dhe qytetare, duke e bërë qytetarin pjesë aktive të vendimmarrjes dhe duke bërë që ai të jetë i njoftuar në kohë reale për zhvillimet përkatëse në komunën e tij", ka thënë Kurti.

Ndërsa ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka treguar se cilat shërbime do të shtohen në "E-Kosova". "Disa nga

shërbimet që planifikohen në fazën e parë janë: Transmetimi i mbledhjeve të asambleve komunale, raportimi i problemeve në komunat përkatëse, informacionet mbi komunat, qasja te pasuria e zyrtarëve komunalë, iniciimi dhe pjesëmarrja në debatet publike. Përmes këtyre shërbimeve qytetarët kanë mundësi t'i adresojnë më lehtë kërkesat e tyre

tek organet komunale. Në fazën e dytë do të përfshihen edhe shërbime të tjera", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, ka thënë se përmes zhvillimit të këtyre shërbimeve do të rritet llogaridhënia e institucioneve. "Reforma ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së punës në

institucione. Jo vetëm që ka më shumë shërbime për të gjithë, por edhe cilësia e tyre po përmirësohet. Po kalojmë në shërbime të plota, cilësore e të qasshme 24 orë në ditë", ka thënë Dobra.

Në ceremoninë e organizuar për lansimin e platformës "E-Komunat" kanë marrë pjesë edhe kryetarë komunash dhe zyrtarë komunalë.

Inspektorati i kryeqytetit largon disa nga tarracat e lokaleve në hapësira publike

PRISHTINË, 17 MAJ - Inspektorati i komunës së Prishtinës është duke vazhduar lirimimin e hapësirave publike të cilat

kanë qenë në shfrytëzim nga lokalet në kryeqytet.

Lajmin e ka dhënë kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama.

"Inspektorati i Kryeqytetit po vazhdon me lirimimin e hapësirave publike të cilat ishin nxënë dhe po shfrytëzoheshin si pjesë

(terrasa) të lokaleve. Këto ditë një e tillë është duke u larguar në zonën qendër në afërsi të 'Pallatit të Rinisë', ka njoftuar Rama.



Ushtarët e FSK-së tregohen të suksesshëm në ushtrimet në Turqi

IZMIR, 17 MAJ - Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është duke treguar përgatitje të lartë profesionale gjatë realizimit të ushtrimit ndërkombëtar "Efes 24" në Izmir të Republikës së Turqisë.

Ushtrimi përfshin grupe misionesh, ku pjesëmarrësit

veprojnë si pjesë e një task-force të përbashkët të kombinuar (CJTF), dhe objektivi kryesor i ushtrimit është shkëmbimi i ekspertizës ushtarake, përmirësimi i ndërveprimit dhe mirëkuptimit midis vendeve partnere dhe agjencive që janë pjesë e ushtrimit.

Kontingjenti i FSK-së ka arritur t'i realizojë me sukses objektivat e trajnimit të cilat ishin të planifikuara për fazën e parë, për të vazhduar kështu me fazën e dytë ku parashihen operacione më të ndërlikuara me forcat ajrore dhe në bashkëveprim me forcat komando turke.



Shoqëria civile: Komisionet për pozita të larta drejtuese po bëhen në kundërshtim me ligjin

PRISHTINË, 17 MAJ - Iniciativa CorrWatch ka reaguar për rekrutimin e zyrtarëve në kategori të larta drejtuese. Sipas kësaj iniciative, rekrutimi është duke u bërë nga komisione që janë ushtrues detyre e jo nëpunës ekzistues.

Iniciativa CorrWatch shpreh shqetësimin e thellë mbi praktikën e qeverisë lidhur me themelimin e komisioneve të pranimit për kategorinë e lartë drejtuese me anëtarë që janë ushtrues së detyrës dhe jo me nëpunës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese siç kërkohet me Ligjin për Zyrarët Publikë, e që për pasojë i bën të paligjshme procedurat e rekrutimit për kategorinë e lartë drejtuese.

Ligji për Zyrarët Publikë, në nenin 48, shprehimisht përcakton se 'Komisioni shtetëror i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese ... ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje... 3.1. tre (3)



nëpunës/ës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese'. Nga kjo dispozitë është e qartë se për të qenë anëtar i Komisionit duhet të plotësohet kërkesa ligjore 'që të jetë nëpunës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese'.

Ligji, me të drejtë ka përcaktuar këtë kriter duke ditur nivelin dhe rëndësinë e kategorisë së lartë drejtuese e që ky kriter nuk plotësohet nëse anëtarët nuk janë nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, përkatësisht për anëtar caktohen ushtruesit

detyrës siç CorrWatch ka vërejtur në disa raste", është thënë në reagimin e kësaj organizate.

Më tutje, kjo organizatë ka theksuar se vendime të tilla janë shqetësuese për faktin se në këto pozita si ushtrues detyre janë të caktuar edhe nëpunës të kategorive më të ulëta, pra nga kategoria e mesme dhe e ulët drejtuese, por edhe nga kategoria profesionale. "Si pasojë, anëtarët e tillë jo detyrimisht përmbushin kërkesat e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese për të qenë të gatshëm të vlerësojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e kandidatëve që kanë aplikuar për kategorinë e lartë drejtuese. Në të njëjtën kohë, fakti që kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin për zyrarët publikë (ligji material) përbën paligjshmëri të procedurës sipas paragrafit 1.5 të nenit 52 të Ligjit për procedurat e përgjithshme administrative. Për më tepër, parakusht ligjor për

themelimin e Komisioneve shtetërore të pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese është miratimi i listës nga qeveria me kandidatët potencial për anëtar të komisionit dhe pastaj të njëjtit përzgjidhen përmes sistemit kompjuterik në mënyrë algoritmike nga njësi përgjegjëse dhe emërohen nga Qeveria me propozim të ministres/it përgjegjës për administratë publike. Këta hapa procedural qartazi nuk janë ndjekur nga qeveria gjatë themelimit të komisioneve shtetërore të pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese", është thënë në reagimin e CorrWatch.

Iniciativa CorrWatch ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës t'i anulojë këto vendime të cilat, sipas saj, bien ndesh me kornizën ligjore të lartcekur dhe të evitohet në të ardhmen një praktikë të tillë që dëmton në mënyrë direkte kredibilitetin e proceseve rekrutuese.

Kërkohet që personave me nevoja të veçanta t'u sigurohet transporti



PRISHTINË, 17 MAJ - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal ka mbajtur dëgjim publik për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Zyrarët Publikë. Përfaqësuesi i personave me nevoja të veçanta, Gentrit Zeqiri, ka kërkuar që t'u sigurohet transporti atyre që ai i përfaqëson, duke marrë parasysh vështirësitë që i hasin. Ai këtë kërkesë e ka bërë në dëgjimin publik për ndryshim-plotësimin

e Ligjit për Zyrarët Publikë, i mbajtur nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal. Në këtë dëgjim publik janë dhënë vërejtje dhe komente për të punuar drejt një ligji më funksional.

Kryetari i këtij komisioni, Valon Ramadani, ka thënë se janë në procedurë për amendamentimin e këtij ligji. Ndërsa Enver Bajqinca, përfaqësues nga Autoriteti Rregullativ i

Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), ka thënë se kanë status të institucionit të pavarur për ta kryer funksionin e saj.

Në anën tjetër, kryesuesi i burimeve njerëzore ka kërkuar që kategoria e zyrtarëve publikë të përjashtohet nga Ligji për Zyrarët Publikë. Kurse deputeti i PDK-së, Njazi Isaku, ka thënë se vërejtjet janë të bazuara dhe do t'i shqyrtojnë tutje, ku është vendosur që takimi i radhës të mbahet të martën e ardhshme.

Hovenieri: Jemi bashkë kundër çdo forme dhune dhe gjuhe urrejtje ndaj komunitetit LGBTQI+

PRISHTINË, 17 MAJ - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Jeff Hovenier, është bërë bashkë me miq nga Kosova, përfaqësues të shoqërisë civile dhe diplomatë të shumtë në Prishtinë, për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë (LGBTQI+). Hovenieri ka thënë se siç ShBA-

ja vazhdon t'i ndajë përpjekjet e përbashkëta për të përkrahur një Kosovë të lirë, paqësore dhe demokratike, gjithashtu qëndron bashkë edhe kundër çdo lloj dhune dhe gjuhe të urrejtjes drejt anëtarëve të komunitetit LGBTQI+. "U bashkua me miqtë kosovarë, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe kolegët diplomatë në Prishtinë për ta shënuar Ditën

Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë sot. Ndërsa vazhdojmë përpjekjet tona të përbashkëta për të mbështetur një Kosovë të lirë, paqësore dhe demokratike, ne qëndrojmë së bashku kundër çdo forme dhune apo gjuhës së urrejtjes ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTQI+", ka shkruar Hovenieri në platformën "X".



ASK-ja: Nuk ka rënie të madhe të numrit të popullsisë në Kosovë

PRISHTINË, 17 MAJ - Ylli Shala, menaxher i Projektit në Agjencinë e Statistikave (ASK), ka theksuar se rënia e natalitetit dhe migrimi janë dy faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënie të numrit të popullsisë por që, sipas tij, në Kosovë nuk ka shumë rënie të numrit të banorëve. Sipas tij, në ditën e fundit pritet të punohet me

orar të zgatur për ta pritur fluksin e qytetarëve të cilët ende nuk janë regjistruar. Shala ka theksuar për "RTK"-në se ky proces ka qenë një nga projektet më të mëdha në vend dhe ka kërkuar angazhim të madh nga të gjithë palët pjesëmarrëse. "Qëllimi i regjistrimit të popullsisë nuk është vetëm numri i popullsisë,

brenda këtij regjistrimi marrim shumë informacione të tjera, të cilat kanë me qenë shumë të leverdishme për komunat, qeverinë, Kosovën për ASK-në, për shkak që kemi shumë indikatorë që nuk kemi mundur t'i dërgojmë në EUROSTAT pa u kryer procesi i regjistrimit", ka deklaruar Shala.



'Sindikatave po u cenohet përfaqësimi në bordin e Trustit'

PRISHTINË, 17 MAJ - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se sindikatave të Kosovës po u cenohet përfaqësimi në bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale (FKPK), i njohur si Trust. Sipas një reagimi për medie të IKD-së, përfshirja e sindikatave në bordin e Trustit është obligim ligjor që duhet të zbatohet pa asnjë vonesë. "Përfaqësimi i tillë kontribuon në një strukturë qeverisëse gjithëpërfshirëse, efektive, shumë të nevojshme dhe të domosdoshme. Punëtorët duhet të përfaqësohen në mënyrë

adekuate në procesin e vendimmarrjes tek përfitimet pensionale (mbrojtjen dhe rritjen e tyre), si dhe ata duhet të kenë mundësinë e ngritjes së shqetësimeve për çdo ndryshim të propozuar në planin e pensioneve", është thënë në reagimin e IKD-së. Këtë reagim IKD-ja e ka bërë rreth përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të Fondit Pensional të Kosovës, për çfarë ka thënë se kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit janë të qarta dhe nuk lënë asnjë bazë për stërzgjatje të procesit.



"Prandaj, IKD-ja, kërkon nga bartësit e institucioneve përgjegjëse, që të shpallin

konkursin për këtë pozitë dhe për pozitën e tjera të lira në bordin e FKPK-së. IKD vlerëson se mos

shpallja e konkursit për këtë pozitë deri tash, reflekton në rezistencën dhe tentativën e guvernatorit të BQK-së, ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve dhe auditores së Përgjithshme, që sindikatave të mos kenë përfaqësim të duhur në këtë organ. Përgjegjësia lidhur me pasojat negative që punëtorët mund të kenë në gjendjen e kursimeve të tyre, respektivisht në reputacionin dhe besueshmërinë e institucionit, si brenda ashtu edhe jashtë, mbetet mbi këta akterë të këtyre institucioneve", është thënë në reagimin e IKD-së.

A po e sjell Shkëlqim Devolli gjigantin "McDonald's" në rajon?



UASHINGTON, 17 MAJ - Sipërmarrësi Shkëlqim Devolli është duke qëndruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një vizitë të karakterit ekonomik. Ai ka takuar në Uashington DC dy politikanë dhe afaristë të suksesshëm, kongresistin demokrat Kevin Hern, dhe senatorin republikan Pete Ricketts. Afaristi nga Kosova, në takime të ndara në Kongres dhe në Senat, i ka njoftuar përfaqësuesit amerikanë për bizneset e "Devolli Corporation" në Kosovë, rajon dhe Evropë, si dhe për afarizmin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke qenë se të dy këta politikanë kanë hyrë në politikë pas sukseseve që kanë pasur si biznesmenë, temë e takimeve ka qenë edhe rritja e bashkëpunimit të deritashëm ndërmjet tregut amerikan dhe

atij kosovar, si dhe mundësitë për bashkëpunime të reja tregtare. Kongresisti Hern ka në pronësi të veten rreth 25 restorante "McDonald's" si dhe për shumë vjet ka shërbyer në pozita të larta udhëheqëse në këtë kompani, që është një ndër brendet më të njohura në botë. Ai ka qenë i përfshirë edhe në sektorin bankar, të teknologjisë, atë të patundshmërive dhe botimeve sportive. Kurse senatori Ricketts, i cili ka ekspertizë të gjatë sipërmarrëse, ka ushtruar edhe detyrën e guvernatorit të shtetit të Nebraskas. Afaristi Devolli ka shprehur interesimin e tij që korporata të cilën e udhëheq të mund të bashkëpunojë me sektorët ekonomikë në të cilët këta politikanë të lartë kanë qasje.

Naftëtarët drejt falimentimit, i bëjnë thirrje qeverisë të marrë masa për çmimet


PRISHTINË, 17 MAJ - Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës ka mbajtur të premtën një takim në të cilin ka shqyrtuar problemet në sektorin e derivateve të naftës. Shqetësimet më të mëdha në këtë takim ishin tek naftëtarët e Gjilanit, ku tash e dy vjet nuk kanë gjetur zgjidhje të problemeve për kontrollimin e çmimeve. Fadil Kryeziu nga "Fama Petrol" në Gjilan i ka bërë thirrje Ministrisë së Tregtisë

dhe kryeministrit Albin Kurti që t'i zgjidhin këto probleme të cilat qëndrojnë tash e dy vjet. Sipas tij, në qoftë se nuk zgjidhen këto probleme, ata do të shkojnë drejt falimentimit. Kurse Fehmi Rexhepi nga "Burimi Petrol" ka thënë se të njëjtë e kanë naftën, por më lirë është duke u shitur me pakicë se me shumicë. Ndërsa kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se do të

bëjnë maksimumin për zgjidhjen e këtij problemi. "Ne do të mundohemi të bëjmë maksimumin për këtë problem. Nuk është mirë, por ne do ta bëjmë maksimumin", ka thënë Berjani. Ndërsa Selajdin Beqa, drejtor i përgjithshëm i Autoritet Kosovar i Konkurrencës, u është kundërpërgjigjur naftëtarëve të Gjilanit, duke thënë se janë shumë të hapur për zgjidhjen e këtij problemi.



Kush ishte në të vërtetë Homeri?



Nga Alice FIGINI

Homeri ka qenë një personazh që ka ngjallur gjithmonë mosmarrëveshje midis studiuesve. A ka ekzistuar vërtetë autori i Iliadës dhe Odisesë? Ky dyshim është ngritur që në kohët e lashta, dhe saktësisht në shekullin VII Para Krishtit kur Kalinusi nga Efesi iu referua qarkullimit të veçantë të dy poezive, të cilat nuk mund të ishin shkruar nga i njëjti person. Debati u thellua në epokën moderne, me botimin e traktatit “Prolegomena ad Homerum” nga Fridrih Volf në vitin 1795, që shënoi fillimin e një sërë studimesh të kritikës analitike mbi poemat homerike, veçanërisht mbi Iliadën, që ishte teksti më i fragmentuar dhe më asimetrik. “Çështja” ka vazhduar deri në ditët e sotme, dhe mbetet kryesisht ende e pazgjidhur si enigmë.

Çështja homerike sipas grekëve

Çështja homerike filloi që në kohët e lashta, në shekullin III Para Krishtit, kur disa studiues të gramatikës filluan të studionin tekstet greke që gjendeshin në Bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Kështu lindi një disiplinë e shkëlqyer e quajtur filologji, por edhe një enigmë e madhe.

Duke analizuar tekstet, studiuesit aleksandrianë Ksenoni dhe Elaniku zbuluan dallime të mëdha midis Iliadës dhe Odisesë, duke ngritur hipotezën se ato nuk i përkisnin të njëjtit autor apo se ky nuk kishte ekzistuar kurrë. Sipas studiuesve vetëm Iliada është shkruar nga Homeri.

Teza e tyre u kundërshtua me vendosmëri nga Arstarku i Samotrakës, që pretendonte se Iliada ishte shkruar kur poeti grek ishte i ri, ndërsa Odisea ishte një vepër e shkruar nga Homeri në një moshë më të pjekur.

Çështja homerike në epokën moderne

Pas shumë vitesh heshtje dhe përpjekjesh intelektuale, çështja homerike u ringjall me forcë në shekullin XVII. Në atë kohë, Abati d’Obinjak shkroi një disertacion pasionant mbi Iliadën, në të cilën ai teorizoi se Homeri nuk kishte ekzistuar kurrë, dhe se në realitet poema e tij ishte një përzierje këngësh të ndryshme të lindura nga tradita gojore të kompozuar në faza të ndryshme.

Ndërkohë Historiani dhe filozofi Xhiambatista Viko hodhi hipotezën se dy poezitë ishin në të vërtetë një vepër kolektive, e krijuar nga i gjithë populli grek. Sipas tij nën emrin Homer, fshi-

heshin një mori bardësh, këngëtarë që e argëtonin publikun në fillim me bëmat e Akilit dhe më pas me ato të Odiseut.

Viko i justifikoi kontradiktat e brendshme të Iliadës dhe Odisesë me të qëniet në fillim rrëfime gojore, të shtjelluara nga disa autorë anonimë. Për më tepër, sipas studiuesit Homeri nuk kishte ekzistuar kurrë, ai ishte një personazh i lindur nga një legjendë. Në shekullin XVIII, kjo hipotezë u mbështet nga filologu gjerman Friedrih Volf.

Çështja homerike në epokën bashkëkohore

Një kontribut interesant në studimet homerike u dha në vitin 1928 nga Milman Perri. Duke analizuar traditën epike sllave të kohës së tij, studiuesi amerikan gjeti disa pika të përbashkëta me poemat homerike. Prandaj sipas teorisë së tij, Iliada dhe Odisea ishin produkt i trashëgimisë orale, siç dëshmohej nga epitetet e ndryshme – formulat e përsëritura për të identifikuar personazhet (p.sh Perëndeshë me krahët e bardhë) – të përdorura për të lehtësuar memorizimin e këngëve.

Ndërkohë në vitet ’90 të shekullit XX, helenisti Vinçenco Di Benedeto deklaroi se Iliada është vepër e një autori të vetëm, të cilin ai e identifikon me emrin e

Homerit. Sipas gjykimit të studiuesit, tek kjo vepër kemi një teknikë rrëfimtare unitare që nuk i atribuohet autorëve të ndryshëm anonimë.

Di Benedeto mendon se Odisea mund të jetë vepër e një poeti tjetër. Sot, studimet mbi veprën homerike janë shumë të polarizuara. Sipas analizës gjuhësore të studiuesit britanik Martin L.Uest, këngët e Iliadës dhe Odisesë paraqesin një strukturë të qartë unitare, dhe për këtë arsye arritën në një version përfundimtar përpara se të shpërbëheshin në traditën gojore.

Uest vë në pikëpyetje teorinë e Parrit, duke deklaruar se në bazë të poemave homerike ekziston një projekt i qartë origjinal, më pas i zgjeruar nga trashëgimia popullore orale, që dikur këndonte legjendat e traditës.

Atëherë kush ishte në të vërtetë Homeri?

Një nga dëshmitë historike për ekzistencën e tij na vjen nga Pindari, i cili pretendon se Homeri ka lindur në qytetin e Smirnes në Turqinë e sotme. Nga ana tjetër Herodoti e gjurmon ekzistencën e Homerit 400 vjet më parë para kohës së tij, dhe pohon se ai ka lindur në Melesigenes, në lumin Meleto. Tregimi i Herodotit, i përfshirë në librin “Vita Herodotea”, thotë se

Homeri nuk ishte emri i vërtetë i poetit, por një pseudonim që iu dha më vonë. Në fakt, Homeri rrjedh nga fjala ‘ho më horōn’ që do të thotë ‘ai që nuk sheh’. Në fakt edhe legjenda thotë se Homeri ishte i verbër.

Ndërkohë poeti Hesiod e konfirmon ekzistencën reale të Homerit, duke pretenduar se ai ishte një nga bashkëkohësit e tij, dhe pretendon se një ditë ata lexuan së bashku poezitë e tyre përkatëse gjatë një konkursi mbi poezinë. Por të gjitha këto rindërtime historike mbi figurën e Homerit janë në kontrast me njëra-tjetrën.

Nuk është ende e mundur t’i jepet një datë e caktuar figurës së tij, dhe as një gjeografi e saktë e përkatësisë etnike. Megjithatë, ka shumë statuja dhe vende të shenjta të ngritura për nder të tij, të cilat tregojnë se si grekët e lashtë e nderonin poetin si një figurë hyjnore, të frymëzuar drejtpërdrejt nga muzat. Prandaj është një personazh legjendar, i rrethuar nga një atmosferë e shenjtë hyjnore.

Iliada dhe Odisea mund të konsiderohen për grekët e lashtë, ajo që është Bibla sot për popullin e krishterë. Ajo nuk ishte thjesht një mit, por një rrëfim që jepte vlera, mendime, urdhërime dhe mund t’i atribuohet vetëm një autori legjendar, Homerit, më i madh se vetë emri i tij. / Solo Libri – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Mezani: Derbi ndaj Dritës, jetik për Gjiljanin



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 MAJ - Xhironja e parafundit në Superligën e futbollit elitare do të zhvillohet sot (e shtunë), ndërsa pritet që shumë ndeshje të jenë derbi të zjarrtë. Normalisht se vëmendja e madhe do të jetë në dy sfida Llapi - Ballkani dhe Gjilani - Drita. Një ditë para ndeshjes, trajneri i Gjilanit, Gentian Mezani, e ka quajtur jetike sfidën ndaj rivalit nga qyteti i Gjilanit, Dritës. Ai kërkon tri pikë nga kjo ndeshje për ta vazhduar fuqishëm garën për t'iu shmangur pozitës që e dërgon skuadrën në barazh. "Jemi para një ndeshje që është shumë e rëndësishme për ne, pasi për kundërshtarin është vetëm një ndeshje e radhës dhe, pa diskutim, një derbi. Për ne është një sfidë jetike. Rezultati i vetëm që na konvenon është fitorja. Jemi mundur që gjatë kësaj jave të bëjmë më të mirën e mundshme dhe i kemi përmirësuar gabimet që i kemi bërë javët e fundit. Duhet t'i marrim tri pikë

për të qenë më të qetë për ndeshjen ndaj Dukagjinit", ka thënë Mezani. Për derbin e skuadrave gilnase foli edhe trajneri i Dritës, Zekrija Ramadani, i cili ka kërkuar fitore për t'i gëzuar tifozët "Intelektualët", por edhe për të qenë në garë për pozitën e dytë. "Jemi para derbit të qytetit, ndër derbit më të fortë në Kosovë. Pa marrë parasysh objektivat e skuadrave, ky derbi gjithmonë ka rezultuar me një luftë sportive dhe angazhim. Derbi mund të vendoset nga një detaj. Kemi objektiva të ndryshme. Ne luftojmë për vendin e dytë e Gjilani për mbijetesë. Shpresoj t'i gëzojmë tifozët dhe futbolldashësit tanë me një fitore. Me tri pikë mund të jemi në garë për vendin e dytë", ka thënë Ramadani. Aktualisht skuadra e Gjilanit renditet në vendin e shtatë me 39 pikë, një pikë më shumë se Feornikeli 74 që është në pozitën që do të luajë në barazh. Në anën tjetër, Dita është e treta me 66 pikë të grumbulluara, dy më pak se Llapi që zë vendin e dytë. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Llapi dhe

Ballkanit që zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti". Skuadra e trajnerit Tahir Batatina me fitore eventuale do t'i afrohet Ballkanit në vetëm një pikë, derisa çdo rezultat tjetër do të ishte në favor të skuadrës së Ilir Dajës në rrugëtimin drejt titullit kampion. Ndeshje e fortë dhe interesante pritet të zhvillohet në Drenas. "Nikli" kërkon tri pikë ndaj Dukagjinit dhe shpreson në gabimin e Gjilanit për t'i ikur vendit të barazhit. Ndërsa skuadra nga Klina nuk ka ndonjë objektiva të madh nga kjo ndeshje. Në ndeshjen tjetër, Prishtina luan ndaj Fushë-Kosovës dhe Malisheva ndaj Lirisë. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 15:00.

SUPERLIGA /Java e 35-të

Të shtunën takohen:
Prishtina-Fushë Kosova
Malisheva-Liria
Feronikeli 74'-Dukagjini
Llapi-Ballkani
Gjilani-Drita

SHKURT

Finalja e Kupës zhvillohet në stadiumin 'Rexhep Rexhepi'

Finalja e Kupës së Kosovës në futboll në mes të Ballkanit dhe Prishtinës do të zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Kjo është bërë me dije nga klubi kryeqytetas FC Prishtina përmes një postimi në faqen zyrtare. "Finalja e Kupës zhvillohet në Drenas, në stadiumin 'Rexhep Rexhepi', të mërkurën më 22 maj nga ora 15:00", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Prishtina e eliminoi Dritën për të arritur në finale, kurse Ballkani rivalen lokale, Suharekën.

Muja: Largimi nga Antwerpi ishte befasi

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Arbnor Muja, u largua nga Antwerpi në janar, për t'u transferuar te Samsunspor në Turqi. Muja ka dhënë një intervistë për mediumin belg "hbvl.be", ku ka treguar disa hollësi të pathëna më parë. "Ky transferim erdhi si befasi për mua. Nuk e kisha ndër mend të largohesha. Antwerpi ishte bërë shtëpia ime e dytë. Për fat të keq, klubi më tha në fund të muajit janar se dashuria më nuk ishte e ndërsjellë. Nuk e kam kuptuar plotësisht vendimin e klubit. Por kështu funksionon futboli. Situata mund të ndryshojë nga dita në ditë. Duhet ta pranosh. Më mungon klubi, tifozët dhe qyteti", ka deklaruar Muja.

Ismajli mund t'i bashkohet Rrahmanit te Napoli

Adrijan Ismajli mund t'i bashkohet Napolit në sezonin e ardhshëm. Vetë lojtari, kur u pyet pak kohë më parë mbi këtë hipotezë, ngriti supet duke lënë të kuptojë se nuk ishte në dijeni, pavarësisht se ndërmjetësi i tij, Serxhio Mezi, theksonte se palët jo vetëm që kanë vendosur kontakte, por janë në një fazë të avancuar. Pavarësisht prej lëndimeve, Ismajli zhvilloi një sezon si protagonist me Empolin, nga lojtarët më të mirë. Për më tepër, qendërbrojtësi kuqezi ka një kosto të ulët. Ismajli do të formonte një dyshe shqiptarësh në qendër të mbrojtjes së bashku me Amir Rrahmanin. Sigurisht për merkaton dhe për emra konkretë, do të flitet më qartë pasi Napoli të vendosë se kush do të jetë trajneri në sezonin e ri.

Të dielën mund të vendoset titulli në basketboll

SUHAREKË, 17 MAJ - Të dielën zhvillohet përballja e katërt finale në mes të Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Mitrovicasit po udhëheqin 2:1 në serinë finale dhe nëse fitojnë do të shpallen kampionë, ndërkohë që therandasit luajnë për fitore dhe për ta barazuar serinë finale në 2:2, në mënyrë që titulli i

kampionit të vendoset në Mitrovicë, në ndeshjen e pestë finale. Në ndeshjen e parë fituan "Xehetarët" 77:68, kurse në sfidën e dytë fituan therandasit 80:79, e në përballjen e mbrëmshme fituan mitrovicasit 85:78. Ylli e kërkon titullin e tretë në histori të klubit, pasi kishte fituar më 2021 dhe 2022, derisa Trepça e kërkon

titullin e kampionit pas 12 vjetësh, pasi herën e fundit fituan më 2012, kurse në përgjithësi e kanë fituar titullin katër herë. Trepça në gjysmëfinale eliminoi Sigal Prishtinën 3:0, derisa Golden Eagle Ylli në çerekfinale mundi Bashkimin 2:0 dhe Pejën në gjysmëfinale 3:2. Ndeshja zhvillohet të dielën nga ora 17:00.



Gjashtë shqiptarë në listën preliminare të Zvicrës për 'Euro 2024'

CYRIH, 17 MAJ - Kombëtarja e Zvicrës ka publikuar listën preliminare, ku ka ftuar 38 futbollistë, për të pasur një pasqyrë më të qartë kur ta publikojë listën finale prej 26 lojtarëve të ftuar. Trajneri Murat Yakin nuk ka arritur

ende të vendosë përfundimisht se cilët lojtarë do t'i ftojë në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024". Kështu, trajneri me prejardhje turke ka vendosur të ftojë 38 futbollistë për një kamp disaditor para fillimit

të Evropianit. Në listën preliminare të helvetikëve bëjnë pjesë gjashtë futbollistë me prejardhje shqiptare. Listës i prijnë dy yjet e përhershëm, Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri. Përveç Xhakës dhe Shaqirit,

në këtë listë jopërfundimtare janë ftuar edhe mbrojtësi Alban Hajdari, mesfushorët Uran Bislimi e Ardon Jashari dhe sulmuesi Andi Zeqiri. Faqja zyrtare e Zvicrës ka njoftuar se lista përfundimtare prej 26



futbollistëve do të publikohet më 7 qershor.

KH Besa fiton gjysmëfinalen e parë, KHF Ferizaj kualifikohet në finale

PEJË, 17 MAJ - Kampionia aktuale, Besa Famgas, e ka fituar ndeshjen e parë gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Në palestrën "Karagaçi" në Pejë, Besa e mposhti Kastriotin me rezultat 30:27. Ndeshja e dytë zhvillohet në fundjavë në Ferizaj, ndërsa skuadra me dy fitore kalon në finale. Ashtu si pritej, ndeshja ishte shumë e fortë dhe betejë e vërtetë sportive nga fillimi e deri në fund. Kishte duele të shumta, ndërsa në fund festuan pejanët. Vendasit nisën më mirë dhe ishin në epërsi deri në minutën e 24-t, kur rezultati u barazua në 11:11. Por sërish Besa u shkëput dhe pas pjesës së parë kishte epërsi prej tri golash, 16:13. Kastrioti ia doli ta barazojë edhe në pjesën e dytë, por më pas Besa Famgas u shkëput deri në pesë gola, 27:22. Dhe epërsinë e mbajti deri në fund. Igor Chiesliov i shënoi nëntë gola nga 14 tentime për Besën. Gjashtë gola nga tetë tentime i kishte Marin Mariq, ndërsa nga katër gola i kishin Nikolla Prcë (4/5), Arbios Mushkolaj (4/11) dhe Jon Vokshi (4/6). 11 pritje i kishte Mursel Mehmeti. Kastriotit



nuk i kryen punë 13 pritjet e Liridon Esatit dhe përjashtimi i hershëm me të kuq i Antonio Vozilas. Gjashtë gola nga tetë tentime i kishte Lulzim Shababani. Me pesë gola nga shtatë tentime ndeshjen e përfundoi Verson Zherka, ndërsa katër gola nga pesë gjuajtje i kishte Alecsander Santos. Katër gola nga nëntë tentime i shtoi Deniz Terziqi. Ndërsa KHF Ferizaj është skuadra e dytë finaliste e plejofit të Superligës së Kosovës në hendboll (femrat). Në gjysmëfinale, Ferizaj e eliminoi Prishtinën. Ferizajaset i shënuan dy fitore bindëse. Fitoren

e dytë Ferizaj e realizoi të enjten pasdite në kryeqytet me rezultat 49:24. Dallimi në cilësi ishte i madh dhe u konfirmua që në pjesën e parë që përfundoi 23:5. Anja Bojaniq i shënoi 11 gola për Ferizajn, kurse 10 i kishte Luljeta Sopjani. Me 8 gola ndeshjen e përfundoi Elsa Kongjeli. Te Prishtina nga 6 gola i shënuan Arona Krasniqi e Enea Ajvazi. Në finale, Ferizaj takohet me Istogun, kampionin aktual. Ferizaj e ka fituar Kupën e Kosovës javë më parë. Ndeshja e parë finale zhvillohet në palestrën "Bill Clinton".

Hamilton: E kam këshilluar Wolffin ta marrë pilot Antonellin

SHTUTTGART, 17 MAJ - Para fillimit të këtij sezoni lajmi "bombë" në Formula 1 ishte ai i largimit të Lewis Hamiltonit nga Mercedesi të Ferrari në vitin 2025. Edhe pse kanë kaluar disa muaj, makina gjermane nuk e ka gjetur ende zëvendësuesin, por piloti britanik i jep një këshillë Toto Wolff, shefit të Mercedesit. Javët e fundit ka pasur disa emra të pilotëve të konsideruar si të përshtatshëm për të plotësuar këtë vend bosh, nga Carlos Sainz (i cili do të largohet nga Ferrari për t'i lënë vendin Hamiltonit) deri te kampioni në fuqi i botës, Max Verstappen. Por janë të shumtë ata që mendojnë se skuadra duhet t'i japë një shans pilotit të ri italian Kimi Antonelli. 17-vjeçari nga Bolonja, i cili garon me Prema në Formula 2, shpreson të ketë



shansin ta pilotojë Mercedesin vitin e ardhshëm (ka shanse të garojë me Williamsin). Vetë Hamiltoni mendon se trashëgimtari i tij ideal do të ishte Antonelli: "Sinqerisht, nuk e kam idenë se cilat janë planet e Totos. Për mua, punësimi i një piloti të ri do të ishte veprim i

duhur. Nëse do të ishte puna ime të zgjidhja me siguri do të merrja Kimi Antonellin. Unë e kam këshilluar Wolffin për këtë pilot të ri dhe ai e ka marrë në konsideratë si ide. Tashmë u takon atyre të vendosin", u shpreh shtatë herë kampioni i botës.

Van Persie emërohet trajner i Heerenveenit

Ish-lojtari i Manchester Unitedit, Arsenalit dhe Fenerbahçes, Robin Van Persie, ka siguruar detyrën e trajnerit të ekipit të parë për herë të parë në karrierën e tij menaxheriale. 40-vjeçari, i cili kishte vendosur t'i 'varë këpuçet në

gozhdë' në fund të sezonit 2019/2020, pas një karriere fantastike, kishte punuar nën urdhrat e Arne Slot si trajner i sulmuesve të Feyenoordit. Ai i ka befasuar të gjithë me metodat e tij të punës, madje ishte ftuar nga Erik

ten Hag për të punuar së bashku me të te Manchester Unitedi. Por tani, pasi i mori hapat e duhur dhe ushtroi kurset e nevojshme për ta marrë licencën e trajnerit, Van Persie ka marrë hapat e tij të parë në karrierën e tij menaxheriale,

duke u emëruar trajner i Heerenveenit. Van Persie ka thënë se po e pret me entuziazëm sfidën e re tek ekipi holandez i cili momentalisht gjendet në vendin e dhjetë në Eredivisie me 10 fitore pas 33 ndeshjeve të zhvilluara. Ish-

legjenda holandeze kishte qenë trajner i grupmoshave U18 dhe U19 të Feyenoordit këtë sezon, por që kishte refuzuar ta merrte drejtimin e U21 pasi kishte shprehur dëshirën ta bënte hapin e madh në karrierë.

SHKURT

Tucheli konfirmon largimin nga Bayerni

Trajneri Thomas Tuchel ka zbuluar se ai nuk do të qëndrojë tek Bayern Muncheno përtej përfundimit të sezonit aktual. Gjatë muajit shkurt Tucheli kishte njoftuar se do të largohet nga gjiganti gjerman në fund të asaj që kishte qenë një sezon zhgënjës. Për herë të parë në 11 sezonet e fundit, Bayerni nuk ishte shpallur kampion i Gjermanisë dhe do ta përfundojë sezonin me asnjë trofe të fituar pasi u eliminua nga Kupa e Gjermanisë dhe Liga e Kampionëve. Më herët gjatë kësaj jave raportime të ndryshme kishin pretenduar se Bayerni mund ta marrë vendimin dramatik dhe ta mbajë Tuchelin në ekip pasi dështoi ta gjejë zëvendësuesin e tij. "Kjo është konferenca ime e fundit për shtyp. Ka pasur bisedime, por ne nuk arritëm një marrëveshje kështu që vendimi i muajit shkurt qëndron ende", ka thënë Tuchel.

Minnesota mposhti Denverin, finalistë caktohet në sfidën e shtatë

Minnesota fitoi thellë 115-70 në gjysmëfinalen e gjashtë play off ndaj Denver, duke barazuar në 3-3 serinë e takimeve. Për pasojë, finalistja e parë në Konferencën e Perëndimit do të dalë nga ndeshja e shtatë dhe e fundit. Ashtu sikurse pritje, Minnesota e shfrytëzoi në maksimum faktorin fushë dhe ndali serinë e 3 fitoreve radhazi të Denverit. Madje me një lojë spektakolare, sidomos në mbrojtje, duke mos lejuar rivalët të shënojnë shumë. Anthony Edwards me 27 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendasit, mbështetur edhe nga McDaniels me 21 pikë. Mirë u paraqit edhe stoli, nga ku erdhën 34 pikë. Për Denverin, Jokiçi realizoi 22 pikë, i pambështetur sa duhet nga shokët.

Xavi rrezikon të shkarkohet në fund të sezonit

Xavi Hernandez është pajtuar ditë më parë për ta vazhduar bashkëpunimin me Barcelonën deri në vitin 2025, por mediet në Spanjë raportojnë se trajneri mund të shkarkohet nga Laporta në fund të këtij sezoni. Kjo ide, hipotezë, apo thjesht thashetheme, vjen pasi Xavi është shfaqur i dorëzuar, duke i rrëfyer presidentit se të konkurrosh me Realin sezonin e ardhshëm do të jetë shumë e vështirë. Kjo deklaratë e Xavit nuk është pritur mirë nga Laporta, pasi Xavi, në momentin që konfirmoi se do të qëndronte te Barcelona edhe vitin e ardhshëm, u shfaq shumë optimist. Në këto kushte, gjithnjë sipas medieve, nuk përjashtohet një shkarkim në fund të këtij sezoni.

Arteta: Duhet të fitojmë dhe të presim të ndodhë magjia

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, nuk pret ndonjë surprizë nga ndeshjet e javës së fundit të Premierë Ligës, me Manchester Cityn që pritet të konfirmohet kampion për të katërtin vit radhazi. Ndërsa "Topçinjtë" do të kënaqen me vendin e dytë. Edhe në rast se Arsenali i tij fiton ndaj Evertonit, kjo mund të mos mjaftojë, pasi "citizens" do të përballet me West Hamin. "Do të presim magjinë që të ndodhë. Ne duhet të bëjmë pjesën tonë dhe tashmë e dimë se çfarë të bëjmë", ka thënë Arteta. "Do të jetë një ditë e mirë për ta përjetuar kampionatin në këtë mënyrë, deri në fund. Do të jetë hera e parë që Premierë Liga do të jetë e hapur, në pritje se çfarë do të ndodhë në stadiumet e ndryshme. Ka vetëm një mënyrë që ne të festojmë në fund në 'Emirates' bashkë me tifozët tanë. Ne duhet të fitojmë, ata jo. S'ka asnjë shans tjetër. Gjithsesi, jam i sigurt që tifozët do të na mbështesin deri në fund", u shpreh Arteta.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 771/24 të datës 17.05.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 17.05.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo filllore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtë. Shpallja është e hapur nga data 17.05.2024 deri me datë 31.05.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 07.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 10.06.2024 deri me datë 12.06.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 17.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 19.06.2024 deri me datë 21.06.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 26.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 27.06.2024 deri me datë 01.07.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 04.07.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 07.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 10.06.2024 deri me datë 12.06.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 17.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 19.06.2024 deri me datë 21.06.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 26.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 27.06.2024 deri me datë 01.07.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 04.07.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë

sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Z.T.P. Euroglass" D.O.O. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810598071 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Z.T.P. Euroglass" D.O.O. Prizren, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810598071 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Z.T.P. Euroglass" D.O.O. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 810598071 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A. u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 791/24 od 17.05.2024, godine od Izvršnog direktora, N.P.L „Perparimi“ Sh. A. 17.05.2024 objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naziv: Fizičko osiguranje – čuvar

Broj izvršitelja: 1

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje imenovanja: Određeni period od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) mjeseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Srednja škola ili osnovna škola

Radno iskustvo: Poželjno šest (6) mjeseci

Izvršava: Rukovodilac Odsjeka za fizičko osiguranje

Visina mjesečne bruto plate: 390.00€.

Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograničenja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slučaju opasnosti odmah obavještava nadležne osobe;
- Po potrebi može biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizičkog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predviđene zaštitne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti protivpožarnu opremu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizičko osiguranje za obavljene posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Fizička sposobnost, poželjno je da ima završene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Poželjno je da ima licencu iz oblasti fizičkog osiguranja;

Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu N.P.L „Perparimi“ Sh. A - Vučitrn.;
- Dokaz o stručnoj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti)
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Stručnog vijeća Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnom krivičnom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju lične karte (skenirano);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 17.05.2024. do datuma 31.05.2024. u 16:00 sati.

Približni kalendar postupka regrutacije:

- Preliminarna verifikacija prijave kandidata najkasnije do datuma 07.06.2024.
- Rok za žalbe od datuma 10.06.2024. do datuma 12.06.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti pisanim testovima i ocjenjivanju najkasnije do datuma 17.06.2024.
- Rok za žalbe od datuma 19.06.2024. do datuma 21.06.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti usmenom intervjuu i ocjenjivanju najkasnije do datuma 26.06.2024.
- Rok za žalbe od datuma 27.06.2024. do datuma 01.07.2024.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspješnim kandidatom najkasnije do 04.07.2024.

Narativni kalendar postupka regrutacije može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, i u zavisnosti od rada ocenjivačke komisije i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnese žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok se ista ne razmotri od strane Komisije za žalbe.

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti prijavi formular u Arhivskoj kancelariji J.P.L „Perparimi“ A.D. u gradu Vučitrn, ul. “Dorda Kastriota Skenderbega” br. 82, (bivši objekat TMK- a pored Osnovnog suda Mitrovica - odeljenje u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Odeljenje za kadrove, primenjujući član 8, stav 3, Uputstva MFPT-br. 01/2024 za časova. Odeljenje za kadrove, primenjujući član 8, stav 3, Uputstva MFPT-br. 01/2024 za časova. Odeljenje za kadrove, pružice potrebna objašnjenja kandidatima u Regulaciju Postupka Konkursa u Javnom Sektoru, pružice potrebna objašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, i pomoći će im i dati potrebne upute za prijavu putem elektronske adrese.

Predaja prijave sa celokupnom traženom dokumentacijom u ovom javnom pozivu mora se obaviti samo putem elektronske adrese kako sledi: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L “Perparimi” S.A. u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa odvijace se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albana Kelmendi shpall te pavlefshme dëftesat sh.m.e. “Ymer Prizreni” Prizren.

- Arif Morina shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Gazmend Imeri shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën , gjendjen e notave dhe mungesave Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Leonard Kajdomqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl V- IX shfmu “ Pjeter Budi “ Lubizhd e Hasit.

- Ardora Vezaj shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën, diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Egzon Sadikaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Heronjtë e Lumes “ Vermice.

- Qamil Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. “ Brigada 125 “ Medvec.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpazj. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

